



ISSN 1961-9367

ISSN en ligne 2261-348X

Ballkani ose mendimi pa hapësirë

Ilir Yzeiri

“Aleksandër Xhuvani” University of Elbasan, Albania
 iliryzeiri@gmail.com

Les Balkans ou la pensée sans espace

Résumé

Cet article repose sur une conception de Baudrillard tirée de son œuvre « Simulacre et simulation ». « L'espace sans idées », c'est le territoire créé dans la carte et sans référence concret réelle. En ce qui concerne les Balkans, cette idée d'espace sans idées signifie plutôt une image qu'un lieu concret. De ce point de vue il est trop difficile d'envisager l'homme balkanique. Par rapport au type européen, l'homme de Balkan existe grâce à l'opposition et pas à l'intégration. Guerres, conflits territoriaux et querelles infinis pour des frontières que les populations des Balkans jugent toujours comme si le voisin les avait violées, c'est ainsi que l'homme des Balkans s'est construit. Pour illustrer cette idée, j'ai analysé un fait de chronique récent, à savoir l'incident durant le match de football Serbie-Albanie, l'histoire de drone qui a provoqué l'interruption du match et a révélé les fantasmes du passé et les frustrations des relations toujours non amicales même hostiles entre les albanais et les serbes. D'un autre côté, j'ai mis face à face une partie des deux grandes œuvres, celle du prix Nobel Ivo Andric, « Le pont » et celle du grand écrivain albanais Isamil Kadare « Le pont aux trois arches ». En conclusion : *Les Balkans* est une pensée sans espace pour que l'espace soit peuplé par des gens qui éprouvent des difficultés à être décentrés et identifiés dans un autre centre. Enveloppés étroitement dans leur identité historique construit avec des mythologies de national romantisme, les Balkans aujourd'hui vivent plus comme pour démontrer ce qu'ils ont une sorte de côté supérieur aux voisins, pour montrer que leur espace est toujours quelque chose qui manque et que l'absence se trouve dans une autre terre qui est adjacente ou dans la mémoire collective et l'imagination. Par conséquent, des symboles créés par des gens ordinaires pourraient provoquer des affrontements violents. Même dans les cas où les écrivains de génie originaires de ces pays essaient de dire les mythologies de leur existence, on remarque combien ces peuples sont différents, faisant partie, depuis plus de cinq siècles, d'un empire qui a détruit les frontières ethniques, mais ayant enfin soulevé la passion quelquefois cachée de ne pas accepter l'autre, le voisin.

Mots-clés : homo balcanicus, ses identité et mentalité

The Balkans or thought without space

Abstract

This article is based on a conception by Baudrillard drawn from his work "Simulacre et simulation". "The space without ideas" is the territory created in the map and without real concrete reference. As far as the Balkans is concerned, this idea of space without ideas means rather an image than a concrete place. From this point of view it is too difficult to envisage the Balkan man. Compared to the European tip, the Balkan man exists thanks to opposition and not to integration. War, territorial conflict and infinite quarrels for the confines that the people of the Balkans always judge as if the neighbor violated them, thus the man of the Balkans is enlarged. To illustrate this idea I analyzed a fact of recent chronicle, namely the incident during the football match Serbia-Albania, namely the history of drone which caused the interruption of the match and revealed the fantasies of the past. And the frustrations of the still unfriendly, even hostile relations between the Albanians and the Serbs. On the other side I put face to face part of the two great works, that of the Nobel Prize Ivo Andric, "The Bridge", and that of the great Albanian writer Ismail Kadare "The Bridge with trio's arches". In conclusion: The Balkans is a spaceless thought for space to be populated by people who have difficulty being decentered and identified in another center. Closely wrapped in their historical identity built with mythologies of national romanticism, the Balkans today live more like to demonstrate what they have as a higher side to neighbors, to show that their space is always something that is missing, absence is found in another land that is adjacent or in the collective memory and imagination. Therefore symbols created by ordinary people, could provoke violent clashes. Even in cases where writers of genius from these countries try to say mythologies of their existence, there are more or even notes how different are these people who for more than five centuries were part of an empire that destroyed the borders ethnic, but finally raised the sometimes hidden passion of not accepting the other, the neighbor.

Keywords: homo balcanicus, his identity and mentality

Sa herë që kam dashur të shkruaj diçka për Ballkanin, më është kujtuar Dora D'Istria dhe libri i saj "Des femme par une femme".¹ Aty, në kapitullin e parë me titull "Les latins et les germains", ajo sjell një varg diferencash që përcaktojnë popullsitë e këtyre rajoneve: " Për gjermanin, që italianin e quan "barbar", galezi është "fqinji i pabesë" ose "armiku i trashëguar" dhe galezi, nga ana tjetër, nuk ka ndonjë opinion më të mirë për triumfatorët e Grécy-së dhe të Azincourt-it. Natyrisht, gratë marrin pjesë në luftë. Gjermanët flasin gjithmonë për "moralin e ulët" të francezëve dhe të italianëve dhe këta, nga ana e tyre, përsëritin në mënyrë të vazhdueshme se "sentimentalizmi" gjermanik fsheh nën një dukje naive, djallëzitet më të ngatërruara të vajzave të Evës." (Përktimi im. I.Y.).² Nëse do të donim të bënim një taksonomi të tillë edhe për tipin ballkanik duke e ndarë në klasifikime të tilla si ballkanasi lindor apo perëndimor, ai helen apo ai neotoman, ai sllavofil apo ai amerikanofil, gjithë sipas një kriteri të jashtëm, do të vërenim se

njeriu ballkanas apo tipi ballkanik nuk ekziston. Jo thjesht për shkak të origjinës, por më shumë për shkak të refuzimit dhe përjashtimit që i kanë bërë njëri-tjetrit, njeriu ballkanas nuk ka vetje të qartë, ai është një fotografi pa referencë. Njeriu ballkanas ka pak a shumë ekzistencë opozicionale ashtu si tingujt në gjuhë në kuptimin që vetëm përballë njëri-tjetrit ose vetëm duke zëvendësuar njëri-tjetrin ata i japin formë ekzistencës së tyre.

Një anë tjetër që më ka interesuar në këtë vështrim është edhe vëmendja që ka ngjallur Ballkani në dijen politike, historike, sociale, kulturore e letrare. Shkurt, çfarë duam të dimë kur flasim për Ballkanin? Çfarë duam të kuptojmë më mirë dhe përse? Nuk dua të sqaroj më tej atë që është pranuar prej të gjithëve se Ballkani nuk shenjon një entitet të mëvetëshëm³.

Një botim i kohëve të fundit me titull “Të emërtosh dhe të klasifikosh në Ballkan” është përpjekur të rindërtojë deridiku një pjesë të hapësirë ballkanike duke vështruar mekanizmin e emërtimit të hapësirës dhe të kohës dhe duke ndjekur në disa raste fatin e popullsisë minoritare ose të marginalizuara⁴. Edhe nga studimet që janë botuar aty të krijohet përshtypja se Ballkani e sidomos ai perëndimor, është një entitet i njohur në histori më shumë prej opozicionit, përjashtimit dhe asimilimit të tjetrit sesa prej tipareve që mund të prodhonte përbashkimi apo integrimi i tyre historik.

Pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe luftës së egër etnike në atë hapësirë, Ballkani u rishfaq në ligjërimin botëror si një hapësirë që ka vetëm një identitet - keqkuptimin dhe luftën. Në qoftë se do t’i referoheshim Levi Strosit dhe konceptit të tij të etnocentrizmit, atëherë si do të na shfaqej Ballkani? Për analogji me Europën që është një realitet etnocentrik që tërheq gjithë pjesën tjetër për shkak të modelit që ka krijuar, Ballkani, është modeli i asaj që në etnologji quhet autocentrizëm. Popujt e Ballkanit afirmohen jo duke u integruar në një hapësirë të përbashkët, por duke u mbyllur më shumë në hapësirat që kanë zënë ose duke luftuar më çdo mjet që të rivendikojnë hapësirat historike sidomos përmes luftës toponomastike⁵.

Nëse Dora D’Istria rendiste tipare që i bënin të ndryshëm europeanët e shekullit XIX, ajo megjithatë, vërente se këta popuj kishin më shumë gjëra që i bashkonin sesa nga ato që i ndanin. Nëse qëndrimi ndaj gruas dhe të drejtave të saj ishte një prej kritereve për të matur lirinë dhe progresin, sipas Dora D’Istrias, luftërat mes europeanëve dhe përplasjet e ashpra mes tyre nuk e penguan krijimin e Europës si një utopi që shumë shpejt bashkë me SHBA-në u bënë modeli i zhvillimit të botës.

Utopia ballkanike asnjëherë nuk është parë në raport me progresin perëndimor dhe me me prirjen drejt tij. Vendet e Ballkanit kanë qenë shtojca të dy utopive të mëdha-asaj perëndimore dhe asaj lindore ose komuniste. Nëse do të vështrojmë

vetëm tri identitete atë serb, grek dhe shqiptar do të vërehet se projektimi i tyre identitar është krejtësisht i ndryshëm dhe i kundërt. Në raport me Europën si qendër e etnocentrizmit të pranuar, serbët e projektojnë veten si pasardhës të sllavëve, grekët e kanë ndërtuar shtetin e tyre si vazhdim i qytetërimit të lashtë grek,⁶ ndërsa shqiptarët paraqiten më të paqëndrueshëm. Identiteti i tyre është rhizomatik, në kuptimin që projektimi i tyre ka ndryshuar nga kristianizmi katolik te Porta e Lartë, pastaj te shqiptarësia.

Historia e re e Ballkanit mund të shenjohej nga dy ngjarje të mëdha, ajo e konfliktit turko-grek për Qipron dhe shpërbërja e ish-Jugosllavisë që u shenjua me luftëra të përgjakshme e genocid. U duk sikur fundi i historisë i Fukuyamës⁷ dhe përplasja e qytetërimeve e Hantigtonit⁸ po gjenin hapësirë në konfliktin që kishin fshehur vendet e ish Lindjes Komuniste dhe që kishin në themel përplasjet për ndërtimin e kombeve shtete. Ndarja e botës në kampe ideologjike që u shenjua sidomos nga sintagma e “Luftës së ftohtë” rezultoi e kapërcyer dhe rënia e asaj që në atë kohë quhej “perde e hekurt”, shfaqti prapa saj një skenë të mbushur me drama e tragjedi që do të nisnin të luheshin me patosin e pamëshirshëm të gjakut.

Kufijtë e lëvizshëm të identitetit

Po sot çfarë përmban teksti i Ballkanit? A ka një narrativë korente për këtë areal? Vështirë të thuhet. Pas shpalljes së Kosovës shtet i pavarur në ligjërimin publik ndërshqiptar u riaktivizua retorika nacionalromantike dhe u duk për një çast se ndryshe nga çfarë thotë Bodrijard te “Simulacre et simulation”⁹, këtë radhë, jo harta do të ndërtonte realen, por realja do të krijonte një hartë të re. Vendosja e kufirit me Malin e Zi apo siç njihet ndryshe “Demarkacioni me Malin e Zi” dhe “Zajednica” ose marrëveshja e komunave me shumicë serbe në Kosovë, kanë riaktivizuar përsëri ligjërimin nacionalromantik dhe po dëshmojnë se malazetët, serbët e shqiptarët nuk janë ende të aftë t’i zgjidhin problemet e tyre të vjetra etnike me kriteret e modelet perëndimore europiane. Është mjaft interesante në këtë anë të shohësh diferencat që kanë në kuptim përfaqësuesit perëndimorë në Kosovë dhe forcat politike atje. Kur vjen puna për kufirin që duhet të shenjohej mes Malit të Zi e Kosovës, riaktivizohen në fakt dy ligjërimi që mbështeten mbi dy mitologji. Mitologjia e forcave konservatore ose nacionaliste të Kosovës e sheh kufirin si shenjën e dallimit dhe në imazhin që ato ndërtojnë i bëjnë jehonë memories kolektive dhe lumenjve të gjakut që janë derdhur sipas kësaj mitologjie për të shenjuar përkatësinë dhe territorin. Sipas këtij koncepti territori është një vend i izoluar dhe i mbrojtur prej frikës së rrëmbimit nga tjetri. Gjithë mitet e luftës në Ballkan janë ndërtuar mbi tokën dhe gjakun e derdhur për të, për atë rrip kufiri thënë shkurt. Ndërkaq, koncepti i aleatëve perëndimorë të Kosovës që përfaqëson

edhe mitin e ri perëndimor për kufirin nuk e ka këtë ngarkesë. Ja si e përshkruan ambasadori i SHBA-ve në Kosovë Delaëie këtë konflikt. Në një intervistë për një të përditshme të Prishtinës, ai thotë: “Pronësia është ndryshe nga shtetësia e tokës. Nëse toka jote është në Pejë, do të mbetet e jotja edhe pas kësaj marrëveshjeje. Nëse ju jeni shqiptar i Kosovës dhe toka juaj është në Plavë, ajo do të mbetet atje, ndërsa megjithëkëtë marrëveshje ajo prapë do të mbetet prona jote. Askush nuk po fal diçka. Thjesht, ajo që po e bëjnë është tërheqja e një vije me ngjyrë më të mbyllur për kufirin që ka ekzistuar së paku prej vitit 1974”.¹⁰

Në qoftë se nuk do të ishte ombrella euroatlantike në këto vende, vështirë të përcaktohet se si mund të kishin rrjedhur ngjarjet. Ajo që vihet re në këtë çast është se arbitrimi ndërkombëtar me shumë vështirësi po arrin të implementojë mënyrën moderne të shenjueshmërisë së kohës dhe hapësirës. Malazetët apo serbët nga njëra anë dhe shqiptarët nga ana tjetër, e kanë të vështirë ta pranojnë njëri-tjetrin me role të ndryshuara ose të njëjta. Serbët dhe malazetët i shohin shqiptarët si tjetrin e ndryshëm që vetëm nëse asimilohen ose aneksohen mund të forcojnë ose të ridimensionojnë identitetin e tyre. Shqiptarët kanë ende të gjalla masakrat, luftërat e fundit të shek.XIX dhe fillimit të shek XX kur aelanca serbo-malazeze me miratimin e Kongresit të Berlinit, Londrës dhe Traktatit të Shën Stefanit më parë, i aneksoi me dhunë krahina të tëra në verilindje të vendit. Poeti kombëtar Gjergj Fishta, veprën e tij madhore “Lahuta e Malcis”¹¹ e ka ndërtuar si një rrëfim homerik pikërisht mbi këto ngjarje. Qoftë malazetët, qoftë serbët apo shqiptarët, në pjesën më të madhe jetojnë me emocionin e ligjërimit paraetnik dhe jo ma arsyen e pranimit të kohës apo të utopisë së re të shoqërive globale. Konflikti që ka nisur mes shqiptarëve veçanërisht për ato dy çështje që cekëm më lart, ka riaktivizuar sidomos në rrjetet sociale ligjërimitin nacionalromantik dhe sa i takon shenjueshmërisë së kohës ka nisur ta identifikojë atë duke e numëruar mbrapsht. Kjo është ajo që paraqitet kryesisht në media apo në rrjetet sociale sepse sa i takon asaj që ndodh realisht, elitat politike të këtyre vendeve, duket se kanë një orientim të qartë euroatlantik dhe shenjueshmëria e ligjërimeve politike të këtyre vendeve paraqit utopinë e një realiteti që shenjohet sidomos me sintagmën e integritetit europian. Ndërkaq deri para shpërthimit të krizës në Turqi përmes asaj që qeveria turke e quajti grusht shteti, në arealin shqiptar kishte filluar të ndjehej shqetësimi për përhapjen ose ringjallejn e neotomanizmit si një formë identifikimi. Janë të njohura grupime apo individë që në vend të identitetit shqiptar, preferojnë identitetin mysliman. Janë të njohura po ashtu edhe fyerjet e poshtërimet nga ana e atyre shqiptarëve që e mbajnë veten me identitet mysliman ndaj Heroit Kombëtar Gjergj Kastriotit, ashtu siç janë të njohura edhe provokimet me nacionalromantizmin e periudhës paraetnike.

Në këtë trajtesë do të doja të interpretoja gjithashtu nga pikëpamja e fenomenologjisë së imazhit dy dukuri, dronin mbi stadiumin e Beogradit dhe përjasjen fenomenologjike të “Urës” së Ivo Andriçit me “Urën me tri harqe” të Kadaresë. Në të dyja rastet më ka bërë përshtypje se narrativa dhe imazhet luajnë një rol të madh në identitetin ekzistencial të shqiptarëve dhe serbëve në këtë rast.

Droni si një shaka historike

Ajo që ndodhi ditën e martë më 14 tetor 2014 në stadiumin e Beogradit ka hyrë tashmë në kronologjinë e marrëdhënieve serbo-shqiptare si prologu grotesk i një marrëdhënieje të mbushur me viktima, urrejtje dhe përjashtim të tjetrit. Ka shumë mënyra për ta lexuar ngjarjen e asaj nate dhe, për hir të së vërtetës, aty mund të gjenden të gjitha fijet e intrigës së tragjedisë, dramës dhe komedisë së marrëdhënieve mes Serbisë dhe Shqipërisë.

Gjëja e parë që të mbetet në mendje pas asaj që ndodhi në Beograd ishte dhuna. Në fakt nuk ishte hera e parë që stadiumet ktheheshin në arena dhune. Mirëpo dhuna që u shfaq në atë stadium ishte konceptuar prej atyre që e realizuan si një betejë e munguar për të larë hesapet mes dy kombeve që e kishin perceptuar njërit-tjetritin si armikun më të madh dhe të dyja palët, të frymëzuara sidomos nga mitologjia e letërsisë heroike, u sulën dhe u ndeshën në fushë me patosin e heronjve të folklorit. Ngjarja e 14 tetorit, sipas mendimit tim, na tregoi edhe njëherë se si mund të transformohen spektaklet sportive në ndeshje lufte. Metaforat e luftës që përdoren rëndom për të komentuar kompeticionet sportive, si “taktika” e skuadrës, e “dërrmoi”, e “uli në gjunjë” e “shpartalloi”, etj., befash, u kthyen në ligjërimin real të luftës dhe ndeshja e futbollit u bë një metaforë e ndeshjes në imagjinatën kolektive mes serbëve dhe shqiptarëve.

Po çfarë ndodhi realisht? Siç u zbulua më vonë, një shqiptar me emrin Ballist Morina lëshoi mbi hapësirën e stadiumit një dron që mbante një flamur ku ishte endur një hartë që tregonte kufijtë e Shqipërisë etnike. Për popujt fqinjë, serbë, malazezë apo grekë ajo është harta e Shqipërisë së madhe që përfshin Shqipërinë, Kosovën dhe rajone të tjera fqinje ku jetojnë shqiptarë. Të gjithë shqiptarët folklorikë që u ngazëllyen me shfaqjen e guximshme të ëndrrës nacionaliste, mbetën të befashuar kur mësuan se Europa u tregua e barazlanguar në dënimin e dhunës në stadium dhe të thirrjeve raciste mbi shqiptarët. Ajo u impresionua shumë nga shfaqja e dronit dhe për një çast e mori si të mirëqënë provokacionin e vetmuar dhe mediat europiane e patën të lehtë që edhe në këtë rast të aktivizonin klishetë dhe stereotipitë e njohura për konfliktet në Ballkan dhe për armiqësinë e egër sidomos të serbëve me shqiptarët. Shteti shqiptar u distancua prerë nga ai

incident, ndërsa qeveria serbe ndërtoi një ligjërim tjetër dhe i dha jetë një utopie fantazmagorike sipas së cilës autori i atij akti të menduar ishte vëllai i kryeministrit shqiptar që ndodhej atë ditë në stadium. Teza e “Shqipërisë së Madhe” është një sajese serbe, deklarimin përfaqësuesit e politikës shqiptare. Mirëpo, disa media kryesore në Europë dhe disa personalitete si ata që përmenda më sipër, nuk e panë dhunën, por u mbeti mendja te droni dhe te “Shqipëria e Madhe”. Kjo mund të ketë edhe një shpjegim tjetër. Europa është e frustruar nga siguria kombëtare dhe nga kërcënimet terroriste.

Pavarësisht gjithë këtyre më sipër, shfaqja e dronit mbi stadiumin e Beogradit, nëse do të vështrohet pa asnjë ngarkesë etnike, politike apo nacionaliste, ishte një provokim që zërtheu në mënyrë tragjikomike frustracionet e vjetra dhe tekstet e ngarkuara me histori luftërash, me patetizëm folklorik dhe me retorikë urretjeje. Personi që lëshoi atë dron mbi stadiumin e Beogradit nuk e dinte se çfarë po bënte realisht, ai thjesht gjeti një vend dhe një mënyrë që të sfidonte tjetrin e ndryshëm, atë që nuk e kishte sfiduar historikisht. Dhe këtë sfidë e kreu me anë të një imazhi, me anë të një harte. Edhe njëherë këtu kthehemi te fabula e bukur e Borgesit që e përmend Bodrijard në librin e tij *Similacre et simulation* kur harta ndërton perandorinë dhe jo perandori.

Në Shqipëri autori i hedhjes së dronit është arrestuar për armëmbajtje pa leje, ndërkohë dhe emri i tij përmendet vetëm nga tifozët e kombëtares shqiptare të cilët e kanë idhull të tyre. Ndërkaq një forcë tjetër politike me frymëzim si imazhi i dronit, Aleanca Kuqezi, nuk arriti të kapërcente pragun elektoral në zgjedhjet e vitit 2013.

Fenomenologjia e urës te Kadare dhe Ivo Andriç

Në Ballkan janë të njohura legjendat apo rrëfimet me elemente të mbinatyrshme që shenjojnë shtratin afektiv apo që përbëjnë në masë të madhe larushinë kulturore të këtyre popujve. Kështjella, Ura, mali apo objekte të tjera të jetës së ballkanasit kanë qenë tema të debatueshme sa i takon historisë që nuk mbaron kurrë për autorësinë apo për vjetërsinë e kombeve në Ballkan. Ndërkaq po të vështrosh dy romanet që kanë në titull shenjën “urë” të Ivo Andriçit dhe Kadaresë do të zbulosh dy pikëshikime të ndryshme ose dy botë që megjithëse janë afër ngjajnë pak ose janë të projektuara me ngjyra që dallojnë.

Që në fillim vërejmë se te Andriç kemi një personazh që na rrëfen një ngjarje të imagjinuar, ndërsa te Kadare, personazhi na rrëfen një ngjarje të trilluar. Ivo Andriç e shkroi veprën e tij gjatë Luftës së Dytë Botërore, në vitet 1942-43 dhe e botoi në vitin 1945. Kadare e shkroi në vitin 1978 këtë vepër dhe, nëse do

t'i përmbaheshim parimit të qëllimshmërisë aq i dashur për fenomenologjinë e Huserlit, do të thoshim se bota që rrëfen narratori i Andriçit, ndryshon krejtësisht nga bota që rrëfen narratori i Kadaresë. "Ura mbi Drin" ose ura e Vishegradit është një objekt real, « Ura me tri harqe » nuk ekziston askund, ajo është një trillim i autorit i cili kërkon të ndërtojë një botë të humbur dhe të harruar që ngjet me botën në të cilën jeton autori. Ura e Andriçit është një sagë moderne që përmbledh gjithë historinë e popujve sllavë të Ballkanit që jetojnë në kufi të njëri-tjetrit. Ata janë bosnjakë, turq, hebregj, serbë. Dikur ishin të ndarë nga lumi Drin, por një djalë i krahinës, Mehmet Pasha, kur po merrej peng nga Sulltani u betua sipas gojëdhënës, se do të ndërtonte një urë që të tjerët të mos vuanin siç vuajti ai kur u transportua në një kosh. Ura bëhet metafora e bashkëjetesës dhe ndarjes. Ura është gjithashtu porta nga vjen i huaji, tjetri, i ndryshmi që ndryshon rregullat dhe stilin e jetesës. Te Kadare **Ura** është shfrytëzuar si një metaforë për të ndërtuar Shqipërinë para pushtimit turk. Nëse Ivo Andriç është përpjekur që të japë gjithë historinë e sllavëve të Ballkanit, nga pushtimi turk e deri në Luftën e Parë Botërore, përmes Urës së Vishegradit, Kadare ka zbërthyer një tekst tjetër ose narratori i Kadaresë lexon një tekst të shkruar më parë. Mua më duket se asnjë prej studiuesve që janë marrë me këto dy romane nuk ka vënë re se fraza me të cilën nis novela e Kadaresë: "Unë murgu Gjon, biri i Gjorg Ukcames, tue u kujtuom se në gluhën tonë ende s'ka gja të shkruom për urën e Ujanës së Keqe...", të kujton pasthënien e librit të parë të shkruar në shqip, "Meshari" (1555) të Gjon Buzikut, në të cilën thuhet "U Doni Gjoni, biri i Bdek Buzikut, tue u kujtuom shumë herë se gluha jonë nuk kish gja të ndigluom n së shkroumit shenjtë, etj...". Kështu, narratori i Kadaresë, murgu Gjon, në qoftë se do t' referoheshim Rikërit e shmang të shenjuarin real që është bota e Gjon Buzikut dhe në vend të saj ndërton botën fiktive të autorit Kadare. Të duket se rrëfimtari i Kadaresë kërkon të ndriçojë jo kronikën e Ujanës së Keqe, por Shqipërinë e para pushtimit otoman. Kadareja e ka projektuar rolin e vet si shkrimtar te murgu i Mesjetës dhe ashtu si ai kërkon të rindërtojë edhe njëherë historinë e shqiptarëve deri sa ajo u zhbë nga pushtimi otoman. Te Ivo Andriç, **Ura**, është indiferente ndaj historisë. Ajo është një dëshmitare e heshtur dhe autori, përmes imazhit të saj, rindërton rrugën, hapat. Ura është vendi më i plotë ku gjurmët e kalimtarëve ose me një metaforë më të plotë, gjurmët e historisë, duken më shumë. Ndërkaq edhe funksioni epistemologjik që merr ura ndryshon te të dy shkrimtarët. **Ura** e Ivo Andriçit dëmtohet nga Perëndimi, nga austriakët; **Ura** e Kadaresë është një ndërtim apokaliptik se ajo do të lejojë që vendi të pushtohet nga hordhitë otomane, që vendi të bjerë në gjumin e rëndë të shfytyrimit për 500 vjet. Të duket sikur kjo fenomenologji e portës së Lindjes dhe Perëndimit funksionon edhe sot. Bombardimet në Beograd gjatë konfliktit të fundit të kujtojnë bombardimet e Urës nga Astro-hungarezët, ndërsa

debatet për modifikimin e historisë dhe për rregullimin e imazhit të otomanëve në vetëdijen kolektive shqiptare i ngjajnë ankthit që ka rrëfimtari i Kadaresë ose trallisjes që murgu Gjon shpreh kur dëgjon gjuhën e tyre që i ngjitet jetës dhe rutinës shqiptare. Rënia e kontëve shqiptarë njëri pas tjetrit po bëhej një ngjarje e rëndomtë. Ndërkaq, një detaj në dukje i vogël do ta prishte drjtpeshimin psikik të kombit. “Në vend të vitit 1379, ata sipas kalendarit islamik dhe kjo ishte një nga kërkesat e pakta të osmanëve, kishin shkruar “hixhra 757”. Fatzestë. E kishin çuar kohën gjashtëqind vjet prapa dhe qeshnin dhe talleshin. Ç’tmerr”. (Ura me tri harqe, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1978, f. 110)

Përfundim

Po ta zgjeroni hapësirën tonë dhe të përfshini këtu edhe Mesdheun atëhere do të na duhej të mbanim në vështrim se kjo hapësirë që nis në Lindjen e Mesme e vjen deri në ujërat e deteve që lagin vendet e Ballkanit ka prodhuar histori, konflikte, ngjarje e përplasje për territore, ide e religjione sa Ballkani do të ngjante si një kapitull në dukje i mbyllur, por në fakt gjithmonë gati për të shtuar ndonjë paragraf, që ose mungonte në kapitujt e mëparshëm ose duhet ngjeshur aty.

Ballkani është një mendim pa hapësirë sepse ajo hapësirë popullohet prej popujve që e kanë të vështirë të shqendëzohen e të projektohen në një qendër tjetër. Të mbështjellë fort në identitetin e tyre historik të ndërtuar me mitologjitë e nacionalromantizmit, ballkanasit edhe sot më shumë kanë dëshirë të demonstrojnë atë që ata kanë si një anë superiore mbi fqinjët, të tregojnë se në hapësirën e tyre gjithmonë diçka mungon dhe se ajo mungesë ndodhet ose në tokën e tjetrit që është fqinj me të ose në memorien kolektive dhe në imagjinatë. Ndaj simbolet e krijuara edhe nga njerëz të rëndomtë, mund të provokojnë përplasje të dhunshme. Edhe në ato raste kur shkrimtarë gjenialë me origjinë nga këto vende përpiqen të rrëfejnë mitologjitë e ekzistencës së tyre, aty më shumë vëren sesa të ndryshëm janë këta popuj që për më shumë se pesë shekuj ishin pjesë e një perandorie që zhduku kufijtë etnikë, por ringjalli në fund pasionet për të përjashtuar tjetrin.

Sot duket se Ballkani ka dëshirë të kapërcejë të shkuarën dhe elitat politike e proceset globalizuese po e ndihmojnë në këtë udhë. Mirëpo ndërsa rrëzohen muret e jashtme të komunikimit, mure të reja ngrihen brenda banorëve të kësaj hapësire që mbetet gjithmonë e paqartë dhe e pakuptueshme në identifikim, mu si në atë kohë kur udhëtarët e shenjtan duke pasur si pikërrifim një vijimësi vargmalesh me emrin turk BALLKAN.

Bibliografi

- Baudrillard, J. 1981. *Simulacres et simulation*. Paris: Galilée.
- D'Istria, D. 1865. *Des femmes par une femme, tome premier*. Paris : Librairie Internationale.
- De Rapper, G., Sintès, P. (ed.). 2015. *Të emërtosh dhe klasifikosh në Ballkan*. Tiranë: Fjala publishing.
- Fishta, Gj. 1937. *Lahuta e Malcis*. Shkodër : Shtypshkronja Françeskane.
- Fukuyama, F. 1992. *La Fin de l'histoire et le Dernier Homme*. Paris: Flammarion, coll. Histoire
- Gazeta EXPRESS, Prishtinë, 4.09.2016 <http://www.gazetaexpress.com/>
- Huntington, S., P. 1996. *The Clash of Civilizations and the Remaking of World Order*. New York: Simon & Schuster.

Notes

1. D'Istria, D. 1865. *Des femmes par une femme, tome premier*. Paris : Librairie Internationale.
2. D'Istria, D. po aty, f. 14.
3. De Rapper, G., Sintès, P. (ed.). 2015. *Të emërtosh dhe klasifikosh në Ballkan*. Tiranë : Fjala publishing. *Hyrje nga Gilles de Rapper dhe Pierre Sintès*, f. 9-11.
4. Po aty, f. 39-113. (Në këtë pjesë të librit trajtohet fati i popullsisë vllëhe ose arumune e sarakacane në Greqi, Serbi, Bullgari. Shën. Im, I.Y.)
5. Vep. cit. Kapitulli Të emërtosh vendet në Ballkan, f. 251-329.
6. Vep. cit. Anne Couderc, Kombi dhe rrethet territoriale : të ndërtosh dhe të emërtosh territorin grek, 1832-1837. f. 269.
7. *La Fin de l'histoire et le Dernier Homme*. Paris: Flammarion, coll. Histoire, 1992.
8. *The Clash of Civilizations and the Remaking of World Order*. New York: Simon et Schuster, 1996.
9. Baudrillard, J. 1981. *Simulacres et simulation*. Paris : Galilée.
10. Gazeta EXPRESS, Prishtinë, 4.09.2016. <http://www.gazetaexpress.com/>
11. Fishta, Gj. 1937. *Lahuta e Malcis*. Shkodër : Shtypshkronja Françeskane.